

URDHËR
Nr. 381, datë 23.6.2020

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT PËR FUNKSIONIMIN E QENDRAVE
PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, JOREZIDENCIALE, QË OFROJNË SHËRBIME PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, GJATË DHE PAS PERIUdhËS SË
FATKEQËSISË NATYRORE, DERI NË PËRFUNDIM TË MASAVE TË
DISTANCIMIT FIZIK/SOCIAL, PËR SHKAK TË EPIDEMISË COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 6.1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Protokollit për funksionimin e qendrave publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas periudhës së fatkeqësisë natyrore, deri në përfundim të masave të distancimit fizik/social, për shkak të epidemisë COVID-19”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror, qendrat publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, si dhe bashkitë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në përfundim të masave të distancimit social, të hartuara në kuadër të epidemisë COVID-19.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

PROTOKOLL
PËR FUNKSIONIMIN E QENDRAVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE,
JOREZIDENCIALE, QË OFROJNË SHËRBIME PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA, GJATË DHE PAS PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE, DERI NË
PËRFUNDIM TË MASAVE TË DISTANCIMIT FIZIK/SOCIAL, PËR SHKAK TË
EPIDEMISË SË COVID-19

Konteksti

Në mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli shpërthimin e pandemisë COVID-19. Në këtë kontekst, më 24 mars 2020, në Shqipëri shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore. Qeveria shqiptare dhe autoritetet shëndetësore morën masa për të përballur shpërthimin e COVID-19 në planin shëndetësor dhe ekonomik. Ndër masat e marra për komunitetet dhe grupet e mëdha të popullsisë, është e rëndësishme të kuptohen nevojat e grupeve specifike, siç janë personat me aftësi të kufizuara. Sipas Qendrës së Kontrollit të Sëmundjeve (*Centers for Disease Control and Prevention CDC*), aftësia e kufizuar në vetvete mund të mos jetë subjekt i rrezikut të shtuar nga COVID-19. Megjithatë, personat me aftësi të kufizuara mund të jenë më të rrezikuar, për shkak se ata kanë situata të tjera shëndetësore bashkëshoqëruese, të cilat rrisin faktorin e rrezikut. Përveç aspektit

shëndetësor, personat me aftësi të kufizuara kanë vështirësi të shtuara në lidhje me aftësimin e tyre, si në fushën akademike ashtu edhe në drejtim të aftësimin, për të realizuar nevojat bazike, si: pavarësinë e tyre, rutinën ditore etj.

Distancimi fizik/social është shpallur në mbarë botën, si një nga strategjitë më të mira për të shmangur transmetimin e COVID-19. Kjo strategji nuk duket shumë e volitshme për personat (prindërit, kujdestarët ose profesionistët), të cilët kujdesen për personat me aftësi të kufizuara, të cilët mund të kenë nevojë për mbështetje ditore ose terapi. Në këtë kontekst, prindërit janë duke u ballafaquar me sfida unike. Shërbimet në qendrat e zhvillimit ose shërbimet e tjera alternative janë ndalur, po njësoj dhe shkollat dhe institucionet e tjera të arsimit dhe të shërbimit për këtë qëllim, janë mbyllur.

Fakti që fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara mund të jenë pjesë e grupeve të riskut të lartë, për shkak të problemeve shëndetësore shoqëruese shton te prindërit stresin, që lidhet me frikën nga prekja ose infektimi. Nevoja për përkujdesje të çdo forme është shumë më e madhe, kur bëhet fjalë për persona me aftësi të kufizuara.

Në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, puna me personat me aftësi të kufizuara, në veçanti, në qendra jorezidenciale preket për disa arsye, si:

- pamundësia për të frekuentuar qendrat prej masave shtrënguese të marra nga qeveria në kushtet e COVID-19, që kufizon marrjen e shërbimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- vështirësia për të aksesuar dhe/ose kuptuar informacionin. Në kushtet e mbylljes së shërbimeve ndaj këtyre personave, përcjellja e informacionit të nevojshëm bëhet edhe më e vështirë;
- prindërve u duhet të “luftojnë”, për të kryer të gjitha detyrat e tyre, si: të punojnë, të kujdesen për fëmijët dhe të kujdesen për veten e tyre, si dhe të marrin rolin e edukatorit special ose terapistit të fëmijës së tyre.

I. Qëllimi

Ky udhëzim ka si qëllim të mbrojë dhe të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara, të përfshihen në qasjen e re digjitale që ofrohet për të gjithë fëmijët në kushtet e fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë COVID-19. Më konkretisht, ky udhëzim synon:

- të sigurojë vazhdimin e mbështetjes për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara në kuadrin e zbatimit të “Standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore, të miratuara me vendim nr. 822, datë 6.12.2006” (më poshtë të quajtura “Standarde të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara”) dhe në përputhje me Manualin e Zbatimit të Standardeve të Shërbimeve për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe në kushtet e fatkeqësisë natyrore”;
- të sigurojë ofrimin e mbështetjes psikosociale për prindërit e fëmijëve/të rinjve në përgjithësi dhe në veçanti, në kushtet e stresit të shtuar, për shkak të COVID-19 dhe masave shtrënguese shoqëruese;
- të aftësojë ofruesit e shërbimeve në përdorimin e mekanizmave të shërbimit *online*, shoqëruar me rregulla dhe kriteret e qarta, për shërbimin e ofruar në këtë mënyrë;
- të rrisë përmes trajnimeve aftësinë e ofruesve të shërbimeve, për të ofruar mbështetje psikosociale për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve/të rinjve me aftësi të kufizuara, për përbalimin e stresit të shtuar;
- të ndërtojë një platformë pune, në përputhje me kërkesat e distancimit social/fizik, kur mbështetja *online* nuk është e mundur ose përfundon;
- të sigurojë respektimin e parimeve dhe të kërkesave, të:
- Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;

- udhëzimet specifike të vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së për COVID-19;
- konsiderime për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara – përgjigje e UNICEF-it ndaj COVID-19 (COVID-19 response – UNICEF);
- mbështetje për fëmijët dhe për familjet përgjatë COVID-19 – Autizmi flet (*Autism speaks*);
- të mësuarit në distancim social – UNESCO;
- personat me aftësi të kufizuara dhe COVID-19 – QKS (CDC).

II. Objekti

Objekt i udhëzimit janë shërbimet e ofruara nga të gjitha qendrat publike dhe jopublike komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara, për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore dhe deri në përfundim të masave të marra për epideminë COVID-19, ku kërkohet distancim social/fizik.

III. Subjektet

Ky udhëzim vendos rregulla, për:

- bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës së qendrave komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara, në territorin e tyre;
- qendrat komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/ të specializuara për personat me aftësi të kufizuara dhe për personelin profesionist të tyre, për punën me personat me aftësi të kufizuara, mbështetjen psikosociale të prindërve e kujdestarëve të fëmijëve dhe bashkëpunimin me ta.

IV. Përgjegjësitë dhe detyrat e Bashkisë, Qendrës dhe Personelit Profesionist

1. Bashkia

- Siguron që fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara marrin shërbimin në formën *online* ose në shtëpi apo në qendër, duke respektuar rregullat e distancimit fizik dhe duke vendosur detyrimisht maskën mbrojtëse.
- Siguron që qendrat të jenë të pajisura me linjë interneti dhe çdo mjet tjetër të nevojshëm për realizimin e shërbimit *online* ose në kushtet e distancimit fizik.
- Në rastet e mbështetjes në kushtet e distancimit fizik (jo *online*), monitorimi i shërbimit sigurohet përmes vizitave në qendër ose në shtëpinë e përfituesit, në përputhje me udhëzimet e vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së, për mbrojtjen personale.
- Ndërton plane për skenarë, si p.sh., personel i reduktuar, identifikon hapat e nevojshëm për shkallëzimin e reduktimit të personelit administrativ dhe teknik.
- Siguron trajnime shtesë, për të përgatitur stafin për situatën e re të krijuar nga COVID-19.
- Bashkëpunon me institucionet e tjera në nivel lokal, qendror dhe organizata të shoqërisë civile, për të prioritetuar cilat janë qendrat apo shërbimet e para aktive, në rast se reduktohen masat shtrënguese të fatkeqësisë natyrore.
- Siguron që qendrat publike të dezinfektohen para fillimit të ofrimit të shërbimit dhe pas, sipas protokollit të miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.
- Siguron që qendrat të jenë të pajisura me mjetet për masat mbrojtëse personale, si: maska dhe/ose viziera, doreza, higjienizues të duarve dhe të mjedisit, si dhe me mjetet e higjienës në përgjithësi.
- Konsultohet me organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara, për të përshtatur e për të gjetur zgjidhjet më optimale, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara.

2. Qendra komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara për personat me aftësi të kufizuara

- Ofron shërbim profesional *online*, duke zbatuar “Standardet e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara”, që marrin shërbime në qendrat ditore dhe “Manualin për zbatimin e standardeve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara”;
- Punon me fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara, në rastin kur ata mundën të përdorin formën digjitale të komunikimit;
- Punon me prindërit apo kujdestarët e fëmijëve/të rinjve, duke u kujdesur që këta të fundit të mund të përdorin formën digjitale të komunikimit;
- Ofron asistencë teknike për prindin, duke e udhëzuar se si të zbatojë objektivat e përcaktuara në programin edukativ individual të fëmijës, për të cilin prindi ka dhënë miratimin dhe ka shprehur vullnet për bashkëpunim;
- Shpërndan informacion në formate të individualizuara, në përshtatje me kufizimet/dëmtimet e ndryshme të fëmijëve/të rinjve;
- Krijon dhe shpërndan materiale me shkrim, në format të thjeshtë për t’u lexuar nga personat me aftësi të kufizuara, të cilët mundën të lexojnë dhe të përthithin informacionin;
- Krijon materiale me figura dhe vizatime të përshtatshme për mbështetjen vizive;
- Ofron shërbim profesional në banesë, pa cenuar kërkesat e distancimit fizik dhe duke respektuar në mënyrë rigorozë maskën mbrojtëse, në përputhje me udhëzimet e vazhdueshme të Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së, kur shërbimi *online* nuk është i mundur pasi prindërit ose kujdestarët e fëmijëve nuk kanë mjete teknologjike për ta realizuar atë;
- Ofron shërbim profesional, pa cenuar kërkesat e distancimit fizik, duke respektuar në mënyrë rigorozë maskën mbrojtëse në qendrat e zhvillimit. Kur masat shtrënguese, për shkak të fatkeqësisë natyrore reduktohen dhe lejojnë qendrat e zhvillimit të jenë operative, në këto raste ndërton plane të riorganizimit të punës, nëse ka reduktim të personelit;
- Përpilon udhëzues dhe ofron trajnime për personelin mbi mbështetjen psikosociale të prindërve dhe kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas situatës së fatkeqësisë natyrore;
- Dokumenton punën e saj në formë të shtypur (printuar) dhe elektronike (platformat sociale, si: *Facebook, Instagram* etj.).
- Siguron pajisjen e personelit me mjetet e mbrojtjes personale bazë dhe higjienizuese, si dhe vendos e realizon masa të shtuara higjieno-sanitare;
- Kontrollon gjatë seancave të këshillimit me prindërit/kujdestarët ose gjatë komunikimit *online* me fëmijët/të rinjtë, nëse ka raste abuzimi ose neglizhimi;
- Në rast se konstatojnë raste abuzimi apo neglizhimi, qendrat venë në përdorim mekanizmat e ankesave dhe denoncimit të abuzimit në përputhje me “Manualin e zbatimit të standardeve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara”, si dhe sipas VKM-së nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;
- Siguron që personeli profesionist, që ofron shërbime në shtëpi, të pajiset me leje qarkullimi nga policia, për të lëvizur në çdo orar, si dhe me logjistikën e nevojshme për të realizuar këto vizita.

3. Personeli profesionist i qendrave

- Personeli, në përputhje me “Manualin për zbatimin e standardeve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara”, si dhe duke pasur në vëmendje situatën COVID-19, ofron shërbim, i cili ka natyrë të shumëfishtë:
 - Punë të drejtpërdrejtë *online* me fëmijë/të rinj, atëherë kur personi ka aftësi të përdorë teknologjinë dhe aftësi për të përthithur informacionin në këtë mënyrë (në rastin kur familja ofron mjete teknologjike);

- Punë në qendër, në ato raste kur është e mundur, duke respektuar distancimin fizik dhe rregullat strikte të higjienës respiratore dhe personale;

- Këshillim me prindërit dhe kujdestarin, si të mbështesin/punojnë me fëmijën/të riun;

- Mbështetje psikosociale për prindërit dhe për kujdestarin, sipas grupeve specifike të problemeve të zhvillimit të personit (dëmtime fizike, motore, të zhvillimit, sensoriale, të të nxëniet) ose sipas problematikës së shfaqur nga vetë prindërit dhe kujdestarët (stres, depresion etj.).

V. Roli i prindërve e i kujdestarëve të fëmijëve dhe personat me aftësi të kufizuara;

- Prindërit ose kujdestari, në përputhje me “Standardet e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara” dhe “Manualin për zbatimin e standardeve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara” janë palë e shërbimit të ofruar;

- Prindërit ose kujdestari kanë të drejtën e shërbimit edhe në kushtet e shërbimit *online* dhe distancimit fizik, si dhe të drejtën për mbështetje psikosociale;

- Prindërit ose kujdestari, brenda mundësive, sigurojnë mjetet e komunikimit digjital për të aksesuar shërbimin *online* të ofruar nga personeli profesionist i qendrës;

- Prindërit ose kujdestari kërkojnë këshillim, në lidhje me zbatimin e detyrave të përcaktuara nga personeli profesionist i qendrës;

- Prindërit ose kujdestari bëhen pjesë aktive e grupeve *online*, që krijohen me ndihmën e personelit profesionist të qendrës; ata kërkojnë ndihmë, sipas nevojës, nga personeli profesionist për përdorimin e mjeteve digjitale të komunikimit;

- Prindërit ose kujdestari zbatojnë të gjitha udhëzimet e shpërndara nga personeli profesionist, në lidhje me rregullat e higjienës dhe distancimit social, të përcaktuara nga udhëzimet e vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së;

- Në rast kur mjediset e qendrës bëhen aktive, prindërit ose kujdestari zbatojnë me rigorozitet rregullat e përcaktuara nga udhëzimet e vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së, për distancimin social dhe fizik; ata shmangin grumbullimet e panevojshme, kur janë duke pritur fëmijët;

- Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për pjesëmarrje aktive dhe vendimmarrje, duke u përfshirë direkt në shërbimin *online*. Atëherë kur kjo është e mundur, duke mbajtur parasysh shkallën e vështirësisë apo të kufizimit të tyre;

- Personat me aftësi të kufizuara që munden, mësohen nga personeli profesionist ose prindërit/kujdestari, të bëjnë një listë me numrat e telefonave të personave të afërm dhe të atyre, që mund të ndihmojnë në rast nevojë dhe praktikojnë telefonatat e nevojshme.

VI. Mënyrat/platformat e ofrimit të shërbimeve në kushtet e distancimit fizik

Në kushtet e fatkeqësisë natyrore, qendra komunitare/ditore/gjysmëditore/e zhvillimit/e specializuar për personat me aftësi të kufizuara dhe personeli profesionist i qendrës, do të zbatojnë një qasje të re, që mundëson vazhdimin e shërbimit për fëmijët, këshillimin me prindërit dhe kujdestarët dhe mbështetjen psikosociale për këta:

- *online*; dhe/ose

- në distancë fizike, duke respektuar masat e higjienës personale dhe respiratore (jo *online*), kur nuk është e mundur *online*, si dhe në kushtet e lirit gradual të masave shtrënguese.

a) Platformë e thjeshtë mbi metodologjinë e mbështetjes *online*:

- Qendra ngre një grup/e mbështetës *via online*, si p.sh., grup/e *Facebook*, grup/e *Skype*, grup/e *Whatsapp*, grup/e *Zoom*, grup/e *Wechat* etj., në varësi të mjeteve të komunikimit që kujdestari/ prindi disponon. Në këto grupe përfshihen prindërit dhe profesionistët, të cilët ofrojnë mbështetje, u përgjigjen pyetjeve dhe japin këshilla;

- Grupet kanë në përbërjen e tyre profesionistë me përvojë dhe të besuar, të cilët u përgjigjen pyetjeve me informacione të sakta, të bazuara mbi të dhëna dhe ofrojnë mjete të përshatshme;

- Bëhet regjistrimi dhe ndarja e videove mes pjesëtarëve të grupit (duke ruajtur të dhënat personale);

- Ndahen video dhe trajnime të ndryshme, që vetë pjesëtarët e grupeve gjejnë në faqet profesionale në internet;

- Ndhimohen prindërit të lundrojnë në informacionin që ofrohet në internet; me qëllim që materialet ose këshillat që gjenden në faqe të specializuara të përdoren në mënyrë të përshtatshme, aty ku shpëtojnë idetë sesi mund të realizohen praktikisht aktivitetet bazë, në përputhje me programet individuale të ndërtuara nga specialistët;

- Ndërtohen plane të qarta mbi mbështetjen, që nevojitet përpara se të realizohen lidhjet video *chat* sipas mjeteve të mësipërme;

- Fiksohen orare për telefonatat që planifikohen të bëhen.

Platforma të video-komunikimit të drejtpërdrejtë

Bashkitë dhe qendrat përdorin platforma si:

- *Skype* – komunikim video dhe audio, *chat* dhe karakteristika të tjera të bashkëpunimit;

- *Zoom* – platformë *cloud* për konferenca video dhe audio, *chat*, *webinars* dhe karakteristika të tjera të bashkëpunimit;

Teams – *chat*, telefonata dhe bashkëpunime të tjera nëpërmjet Microsoft Office *software*.

Sisteme të menaxhimit të mësimin digjital

Qendrat përdorin platformat e mësimin *online* për të shpërndarë planet e edukimit individual (PEI) dhe programet ditore. Sistemet më lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorura edhe nga sistemi arsimor në Shqipëri janë:

- *Google classroom* – ndihmon formimin e klasave në distancë, komunikimin dhe organizimin e materialeve;

- *Schoology* – mjete për të mbështetur dhënien e informacionit, mësimin, bashkëpunimin dhe vlerësimet kur është e mundur.

b) Platformë e thjeshtë mbi metodologjinë e mbështetjes në distancë fizike (jo *online*), kur nuk është e mundur *online*, si dhe në kushtet e lirisit gradual të masave shtrënguese

- Qendra organizon dhe realizon mbi bazën e një kalendari të paracaktuar, vizitat 1:1 pranë mjediseve ku ndodhet fëmija (në banesë), duke mbajtur distancimin social/fizik, për të ofruar mbështetjen;

- Qendra përdor shërbimin postar për dërgimin e materialeve didaktike për fëmijën, nëse ky shërbim është një mundësi;

- Në rastin kur masat shtrënguese të gjendjes së fatkeqësisë natyrore lehtësohen dhe qendrat lejohen të fillojnë aktivitetin e tyre, qendra vijon të respektojë rregullat strikte të distancimin fizik brenda mjediseve të saj, duke rregulluar oraret e frekuentimit, në mënyrë që të mos krijohen grumbullime: të ruhen distancat fizike midis profesionistit dhe personit me aftësi të kufizuara dhe midis vetë këtyre të fundit, të shmanget ngrënia kolektive, të shmangen aktivitetet dhe lojërat didaktike në grup, të nxitet sa më shumë puna në mjedis të hapur kur janë kushtet; gjatë gjithë kohës të mbahen maska dhe/ose viziera dhe doreza nga punonjësit; të mos lejohet grumbullimi i prindërve;

- Qendra siguron zbatimin rigoroz të rregullave të higjienës, në përputhje me udhëzimet e vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së, duke caktuar një punonjës, i cili çdo ditë kryen procedurën, si më poshtë:

- mat temperaturën (në ballë) me termometër digjital;

- dezinfekton/larje duarve të personave në qendër;

- dezinfekton duart e stafit me përmbajtje alkooli 70%;

- sigurohet që të gjithë të pastrojnë/fshijnë këpucët në hyrje të qendrës, në tapetin e përgatitur enkas me sol hipoklorit 0,5–1%;

- në rast të konstatimeve të një nga simptomave, punonjësi i qendrës komunikon menjëherë me prindin/kujdestarin dhe konsultohet me mjekët në numrin 127, mbi hapat që duhen ndërmarrë.

VII. Fushat e punës së personelit profesionist me personat me aftësi të kufizuara janë:

i. përshtatja e planit edukativ individual (PEI).

PEI duhet të rishikohet duke mbajtur parasysh disa kushte paraprahe:

- a) Cilat janë aftësitë që duhet të punohen me fëmijën/të riun?
- b) A janë programet e propozuara, në përputhje me punën e bërë deri përpara ndërprerjes së punës së drejtpërdrejtë, me personin me aftësi të kufizuara?
- c) Cilat janë format e komunikimit, si: mjeti, orari, shpeshësia, midis prindit ose kujdestarit të PAK-ut dhe profesionistit?
- d) Cilat janë kushtet mjedisore, në të cilat do të punohet me fëmijën, duke ditur që mjedisi ndikon në punën me fëmijën me aftësi të kufizuara?
- e) Pajisja me mjetet e nevojshme për realizimin e PEI-it (ose përshtatja e PEI-it, sipas mundësive që ka familja).

f) Programi edukativ individual i përshtatur, hartohet mbi logjikën e programit edukativ individual ekzistues, i cili zbatohet nga specialistët në mjediset terapeutike të qendrave, por tashmë objektivat modifikohen dhe thjeshtëzohen, duke mbajtur në konsideratë, që mjedisi do të jetë familja dhe personi mbështetës do të jetë prindi. Njëkohësisht rishikohet edhe pjesa e materialeve, që do të përdoren, duke i udhëzuar prindërit të përdorin materiale të riciklueshme dhe objekte që janë lehtësisht të aksesueshme në mjedisin familjar.

ii. Higjiena dhe autonomia personale

Higjiena ndjek rregullat në përputhje me udhëzimet e vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së, por sipas strategjisë që është përdorur në qendrat e zhvillimit dhe që u është shpjeguar prindërve. Puna e stafit fokusohet në larjen e shpesh të duarve, dezinfektimi i tyre, higjienën e larjes së dhëmbëve, higjienës gjatë kryerjes së nevojave personale. Për këtë qëllim, puna fokusohet te zinxhiri i mësuar me hapa, p.sh., i larjes së duarve:

- a) në fillim hapim çezmën;
- b) fusim duart në ujë;
- c) pastaj marrim sapunin dhe procesi zgjat jo më pak se 20 sek etj.

iii. Higjiena e gjumit dhe e ushqyerjes

Personeli profesionist asiston prindërit me higjienën e gjumit dhe të ushqyerjes. Edhe pse në kushte kur fëmija e ka shumë të vështirë të respektojë orarin e gjumit dhe të përmbushë nevojat e veta për gjumë, higjiena e gjumit respektohet me shumë durim dhe vendosmëri. Oraret e ngrënies së darkës (minimalisht 3-4 orë përpara se fëmija të shkojë për të fjetur), mospirja e shumë lëngjeve në orët e darkës (edhe pse këto mund të jenë rutinë për disa fëmijë), respektohen maksimalisht. Lojërat që mund të zhvillojë fëmija në orët e darkës duhet të jenë të qeta. Fëmija duhet të shkojë për të fjetur gjithmonë në të njëjtin orar, në mënyrë të përsëritur.

Ushqyerja kërkon kujdes maksimal dhe shumë durim e përkushtim, që fëmija të mos ushqehet kryesisht me ushqime të pasura me sheqer. Është e provuar se sheqeri aktivizon shumë sistemin nervor qendror dhe, për rrjedhojë, kemi rritje të sjelljeve problematike.

Fëmijët nuk duhen lejuar të ushqehen në mënyrë selektive, sipas rutinës së tyre, sepse dëmton shëndetin e tyre. Pamundësia e ndërhyrjes për prishjen e kësaj rutine, i jep informacion fëmijës se mund të shfaqë sjellje problematike, që është e vështirë të ndryshohen.

iv. Historitë sociale dhe mbështetja vizive

Personeli profesionist përdor historitë sociale dhe mbështetjen vizive gjatë ofrimit të shërbimit, si dhe ndihmon prindërit/kujdestarin t'i përgatisin vetë këto mjete, në kushtet e shtëpisë, kur është e mundur. Historitë sociale ndihmojnë fëmijët me autizëm, si dhe fëmijët e tjerë me aftësi të kufizuara

të mësojnë shumë mbi situata të reja dhe të panjohura për ta. Rasti i sëmundjes, si p.sh., gripi, duhet shpjeguar nëpërmjet historive sociale. Fëmija duhet të familjarizohet me fjalët e reja, me faktin se duhet të marrë mjekimin (në rast nevojë), me figurën e doktorit dhe të spitalit, qëndrimin shtrirë etj. Të gjitha historitë sociale ndërtohen shumë të thjeshta, të mbështetura me figura ose vizatime të thjeshta nga familjarët.

Videot e thjeshta ilustruese i ndihmojnë fëmijët.

Qëllimi është që fëmija të bashkëpunojë në rrethana ku të tjerët (persona jashtë kujdesit të ngushtë të fëmijës, si p.sh., doktorët, infermierët) nuk kanë përvojë sesi të punojnë me këta fëmijë.

v. Qëndrimi në shtëpi

Personeli profesionist i qendrës punon për qëndrimin në shtëpi të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke mbështetur prindërit/kujdestarin me mjetet dhe mënyrat e nevojshme. Fëmijët në ditë veçimi/izolimi ndryshojnë rutinën e tyre të frekuentimit të kopshtit, shkollës, qendrës së zhvillimit, këndeve të lojërave, dyqaneve apo të afërmve. Ndryshimi i rutinës dhe paqartësia se çfarë duhet të bëjnë gjatë ditës rrit shumë nivelin e stresit dhe bëhet burim për sjellje të papërshtatshme ose agresivitet. Në këto kushte, personeli profesionist i qendrës mbështet duke ndërtuar një rutinë të qëndrimit në shtëpi dhe duke ia shpjeguar atë prindërve dhe fëmijëve (kur është e mundur) me anë të mbështetjes vizive; mbështet për krijimin e një liste me aktivitete dhe orare të sakta dhe të përsëritura; nxit prindërit/kujdestarin që të kujtojnë fëmijën të shikojë listën (të vendosur në mënyrë shumë të dukshme) dhe ta udhëzojnë atë të vazhdojë me aktivitetin e parashikuar. Nëse fëmija e di se çfarë do të bëjë më pas, niveli i ankthit dhe, për pasojë, edhe sjelljet problem reduktohen dukshëm.

Një listë me aktivitete dhe figura përkatëse ndihmon shumë fëmijët të ulin nivelin e ankthit, si dhe prindërit dhe gjithë familjen të ruajë qetësinë që është e domosdoshme në ditë epidemie.

vi. Sjelljet e papërshtatshme

Personeli profesionist mbështet prindërit në rastin e sjelljeve problem. Për shkak të izolimit është e pritshme rritja e sjelljeve problem. Për këtë qëllim, personeli profesionist “lufton” që prindërit/kujdestari të mos bien pre e “shantazhit” apo “sjelljeve problem”, që paraqiten në këto raste. Personeli profesionist vë theksin të qëndrimi i prindërve për të mos plotësuar kërkesat të cilat nuk kanë funksion përveçse plotësojnë stereotipinë e fëmijës. Në vend të stereotipisë, prindërit/kujdestari këshillohen të krijojnë rutinën e aktivitete të përmendura më sipër. Aktivitetet rutinë, të propozuara nga personeli profesionist, qetësojnë shumë fëmijën.

Në raste të sjelljeve të papërshtatshme, prindi duhet të kërkojë dhe të marrë ndihmë të specializuar dhe të shtuar nga specialisti.

VIII. Fushat e mbështetjes psikosociale nga personeli profesionist për prindërit dhe për kujdestarët

Mbështetja psikosociale targeton mirëqenien fizike dhe mendore dhe aftësinë për të funksionuar të individëve, të cilët ndodhen në një kontekst të kombinimit të faktorëve psikologjikë dhe mjedisit social. Mbështetja psikosociale është ofrimi i burimeve psikologjike dhe sociale për një individ nga shërbimi mbështetës, me qëllim që individi përfitues të rrisë aftësitë për t'u përballur me problemin. Kjo qasje kalon në disa hapa kryesorë, që janë: vlerësimi psikosocial; mbështetja psikosociale dhe përshtatja.

Vlerësimi i nevojave (në kushtet e fatkeqësisë natyrore) realizohet me anë të një interviste të thjeshtë të strukturuar, që kryhet me telefon midis profesionistit dhe prindit/kujdestarit. Qendra organizon cili profesionist do të këshillojë/mbështesë cilin prind/kujdestar dhe ndërton kalendarin e seancave të këshillimit me orare të paracaktuara. Prindi/kujdestari njoftohet paraprakisht për orën e takimit *online*.

Formati i seancave të mbështetjes psikosociale është me grupe të mëdha ose të vogla, sipas llojit të problemit që kanë fëmijët (p.sh., prindërit e fëmijëve me autizëm formojnë një grup), me grupe mikse ose me grupe që mbajnë parasysh faktorë më të përgjithshëm që nuk lidhen vetëm me llojin e aftësisë së kufizuar, siç janë stresi i shtuar, depresioni etj.

Disa tema këshillimi dhe mbështetjeje psikosociale janë:

- përballja me krizën e shkaktuar nga koronavirusi;
- kujdesi për veten në kohën e koronavirusit (prioritizimi i mirëqenies së prindit/kujdestarit është në përfitim të të gjithë familjes);
- ankthi në përballjen me koronavirusin (menaxhimi i shqetësimeve dhe ankthit të fëmijës dhe vetë prindit/kujdestarit);
- qetësia e mendjes ndihmon përgjatë krizës (këshilla për të ulur ankthin gjatë kohës së vështirë);
- të flasim me fëmijët për infeksionin e koronavirusit (fëmijët shqetësohen më shumë kur nuk u shpjegohen gjërat ose u mbahen të fshehta. Si të bisedoni me ta);
- si të mbështesim fëmijët me ADHD dhe t'u ndërtojmë atyre strukturën ditore gjatë COVID-19 (menaxhimi i vëmendjes);
- prindërit *single* gjatë COVID-19 (strategji menaxhimi për prindërit e vetëm);
- prindërimi gjatë koronavirusit: menaxhimi i zemërimit dhe i frustrimit;
- prindërit që humbasin toruan, si të ruajnë qetësinë në kushtet e stresit;
- autizmi dhe koronavirusi, si të flasim me fëmijët me autizëm për koronavirusin dhe si t'i mësojmë të lajnë duart dhe të zhvillojnë skedat e aktiviteteve ditore.

ix. Rregulla të organizmit të brendshëm të shërbimeve

Qendra dhe personeli profesionist ndërtojnë rregulla të qarta të ofrimit të shërbimeve, të cilat marrin parasysh:

- Shpeshhtësinë e shërbimeve që përcaktohet duke ruajtur shpeshhtësinë e ofruar në mjediset e qendrave përpara periudhës së fatkeqësisë natyrore, si dhe duke e përshtatur atë me ecurinë e shërbimit *online* apo në kushtet e distancimit fizik;
- Kohën e shërbimit që përputhet me orarin që përcakton Kodi i Punës, por edhe në marrëveshje me mundësitë e prindërve/kujdestarit;
- Ndarjen e detyrave përmes një platforme komunikimi *online* nga personeli profesionist, pa praninë e prindërve/kujdestarit; në rastin e qendrave me numër të madh personeli dhe fëmijësh që përfitojnë nga shërbimi, personeli profesionist ndërton një rotacion, p.sh., një pjesë e stafit punon për një numër të caktuar ditësh në ofrim shërbimi *online*, ndërsa pjesa tjetër merret me shpërndarjen e materialeve pranë vendit ku ndodhet fëmija për rastet kur nuk është i mundur përdorimi i teknologjisë;
- Menaxhimin e rasteve dhe të sfidave të hasura, që diskutohen në konferenca *online* periodike të caktuara nga personeli profesionist; personeli profesionist dakordësohet që, për periudha të caktuara kohe, secili profesionist të menaxhojë të njëjtat raste me qëllim lehtësimin e shërbimit në kushtet *online*;
- Zhvillimin e trajnimeve si dhe ndarjen e përvojave të personelit profesionist në lidhje me punën me prindërit/kujdestarin në kushtet e qasjes së re.
- Në rastet kur identifikohen persona me COVID-19, në këto grupe apo qendra dhe komunitetet, menjëherë lajmërohet NJVKSH-ja përkatëse dhe lehtësohet bashkëpunimi me strukturat e shëndetit publik në drejtim të hetimit të kontakteve dhe të masave mbrojtëse të izolimit, karantinës etj.

x. Çështje të etikës dhe adresimi i rasteve të abuzimit ose të neglizhencës

Në rast se konstatohen raste abuzimi apo neglizhimi, personeli profesionist vë në lëvizje mekanizmat e ankimit dhe të denoncimit të abuzimit ose të neglizhimit, në përputhje me “Manualin e zbatimit të standardeve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara”, si dhe sipas

VKM-së nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”; personeli profesionist realizon konstatimin gjatë seancave të këshillimit *online* me prindërit/kujdestarin ose fëmijën me aftësi të kufizuara kur ky/kjo e fundit ka mundësi të marrë shërbimin në këtë formë, si dhe gjatë dhënies së shërbimit nëpërmjet distancimit social dhe fizik; rastet e konstatuara të abuzimit, më parë kalohen për informim në platformën e përbashkët elektronike të personelit profesionist (pa prindërit/kujdestarin) dhe, më pas, zbatohen mekanizmat e sipërpërmendur;

- Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë objekt i stigmës apo i diskriminimit social, në rast se preken nga COVID-19; në këto raste, personeli profesionist kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës dhe të familjes së fëmijës në përputhje me KDPAK-un dhe me kuadrin ligjor shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.